



### VENDIM

Nr.44 Datë 07.04.2015

### PËR

### FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KACNI”.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “KISI-BIO-ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 3,87 MW.

#### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KISI-BIO-ENERGJI” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1- Formati i aplikimit nuk është plotësuar në mënyrë korrekte

Neni 9, pika 2-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3- Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.1-Te dhëna specifike për HEC janë plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.2-Te dhënat për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin janë plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3-Dokumentacioni teknik dhe grafik është plotësuar pjesërisht

Neni 9, pika 4.1.4-Dokumentacioni tekniko- ekonomik është plotësuar tërësisht

Neni 9, pika 4.1.5-Leje nga institucione të tjera, është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/te Pjesëshem dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, të paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për liçensimin e shoqërisë **“KISI-BIO-ENERGJI”** sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kacni” me fuqi totale 3,87 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**